



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



0101/ Nr. 3107/2018  
Data: 11.04.2018

**PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS**

Procesverbali nga mbledhja e tretë - III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.03.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Bajrush Laç (Shef i zyrës Ligjore), Abil Thaçi (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të NPL "Pastrimi"), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit), dhe qytetarë të ndryshëm të komunës së Hanit të Elezit. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se mungon një anëtarë i kuvendit të komunës (z.Mehmet Ballazhi).

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i propozim vendimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2017.
3. Miratimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimin) e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
4. Shqyrtimi i raportit një vjeçar të NPL "PASTRIMI".
5. Miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.
6. Miratimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2017.
7. Miratimi i raportit të punës së tri Komiteteve Konsultative për vitin 2017.
8. Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017.
9. Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.
10. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës keni edhe dy material shtesë, kërkesën e kompanisë "ACHRO" SH.P.K dhe kërkesë për ndërrim destinim të pronës. Lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- përveç tri pikave të rendit të punës të cilat janë përgatitur mirë për seancë, tjerat nuk janë përgatitur mirë. E them këtë për arsye se asnjë shkresë përcjellëse e cila e përcjellë materialin nuk është e protokolluar , nuk është e nënshkruar. Unë mendoj që këto pika sipas meje nuk duhet të shqyrtohen.

Avni Bushi thekson:- është e vërtetë se të gjitha janë dërguar në vord për arsye se po ka problem për me u hap dokumentet, mirëpo të gjitha materialet janë nënshkruara, të vulosura dhe të protokolluara. Në mandatin e kaluar jemi pas dakorduar që të gjitha me i përcjellë me vord dhe nëse jeni në dakord për seancat e radhës të gjitha i skanojmë dhe i përcjellim por mund të kemi probleme sepse nëse skanohen bëhen megabajt më shumë dhe imella nuk i dërgon komplet. Ne do t'i përcjellim ashtu siç të kërkonti ju si anëtarë të kuvendit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim materialin shtesë, rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i propozim vendimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2017.
3. Miratimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimin) e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
4. Shqyrtimi i raportit një vjeçar të NPL"PASTRIMI".
5. Miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.
6. Miratimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2017.
7. Miratimi i raportit të punës së tri Komiteteve Konsultative për vitin 2017.
8. Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017.
9. Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.
10. Miratimi i kërkesës së kompanisë "ACHRO" SH.P.K.
11. Miratimi i kërkesës për ndërrim destinim të pronës.
12. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

Mefail Suma thekson:- e them këtë se zakonisht fjalitë kur shkruhen në fillim të fjalisë shënon kryefjala duhet të zëvendësohet dhe të jetë e them këtë se zakonisht fjalët kur shkruhen në fillim të fjalisë shënon kryefjala.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë vërejtje, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Miratimi i propozim vendimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2017.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Shabi rexfhallari thekson:- komuna e Hanit të Elezit, planin për të hyrat vetanake e ka pasur në lartësi prej 239,854.00 €, kurse deri në përfundim të vitit 2017, më konkretisht deri me datën 31.12.2017 është konstatuar rritja e shumës prej 763.74 € më shumë nga ndikimi i realizimit/inkasimit mbi planifikimin e paraparë prej 239,854.00 €, pra në total, financimi i buxhetit nga të hyrat vetanake do të jetë 240,617.74 €. Këto mjete si rezultat i inkasimit/realizimit i shpërndajmë në programet / nën-programet buxhetore dhe kategorinë ekonomike të shpenzimeve, si vijon: mallra dhe shërbime në shumë prej 763.74 €. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe shërbime në shumë prej 763.74 € në programet dhe nën-programet, si vijon: Në programin Administrata dhe personeli (163) nën-programi administrata (16335), kodi funksional (0133), nën kategoria ekonomike, furnizim për zyre, kodi ekonomik 13610 shuma prej 434.24 €. Në programin Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721), nën kategoria ekonomike, furnizime mjekësore, kodi ekonomik 13630 shuma prej 329.50 €.

Akif Shkreta thekson:- nga ka ardhur kjo rritje e të hyrave vetanake.

**Mefail Suma** thekson:- te propozim vendimi për rritjen të hyrave vetanake për vitin 2017 , drejtori për buxhet dhe financa ka bërë kërkesë në kuvendin komunal që ta miraton këtë propozim vendim. Do të ishte mirë që të neni 6 (gjashtë) paragrafi dy në fund të fjalisë të shënon në bazë të kërkesës së drejtorisë për buxhet dhe financa, për shkak se nëse miratohet vendimi dhe nëse nuk përmendet kërkesa askund shtrohet pyetja se ka i mor shënimet zyrtari ligjorë që i paraqiti.

**Shabi rexhallari** thekson:- sa i përket rritjes ka qenë te dy drejtoritë te administrata dhe te shëndetësia dhe për atë duhet të dërgohen në këto drejtori.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR RRRITJEN E BUXHETIT NGA TË HYRAT VETANAKE PËR VITIN 2017

**3. Miratimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimin) e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

**Shabi rexhallari** thekson:- të hyrat e bartura nga viti 2016 në vitin 2017 kanë qenë në shumën prej 86,192.14€ dhe prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 31,439.67 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 54,752.47 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2017 kanë qenë në shumë prej 240,617.74 €, prej tyre janë të shpenzuara 113,852.44 €, kurse për bartje janë edhe 126,765.30 €. Pra, të hyrat vetanake të vitit 2016 dhe 2017 në total janë në shumën prej 181,517.77 €, të cilat i bartim për vitin 2018. Këto mjete i shpërndajmë nëpër këto programe / nën-programe buxhetore dhe kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon: mallra dhe shërbime në shumë prej 4,343.53 €; subvencione dhe transfere në shumë prej 1,691.40 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 175,482.84 €. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në shumë prej 4,343.53 €, në programet dhe nën-programet si vijon: Administrata dhe personeli (163) nën-programi (16335), kodi funksional (0133), shuma prej 975.03 €; shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (75050), kodi funksional (0721) shuma prej 3,150.50 €; Shërbimet sociale dhe rezidenciale (755) nën-programi (75671) kodi funksional (1040) shuma prej 218.00 €. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere në shumë prej 1,691.40 €, në programin dhe nën-programin, si vijon: Zyra e kryetarit (160) nën-programi (16035), kodi funksional (0111) shuma prej 1,691.40 €. Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale në shumë prej 175,482.84 € në programet dhe nën-programet dhe në projektet, si vijon: Administrata dhe personeli (163) nën-programi (16335), kodi funksional (0133) shuma prej 11,810.64 €. Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjenca (180) nën-programi (18444), kodi funksional (0320) shuma prej 10,000.00 €. Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480), kodi funksional (0620) shuma prej 88,582.62 €. Arsimit dhe shkencë (920) nën-programi (92175), kodi funksional (0980) shuma prej 65,089.58 €. Në tabel janë të shënuara në detale dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Akif Shkreta** thekson:- për shërbime publike është dashur të parashihet për shkak se e dimë që është drejtori që lidhet pak më shumë edhe me emergjenca. Për veturat zyrtare mjetet a janë planifikuar apo a është blerë. Në kuadër të vendosjes së kamerave hasa me një tabelë që shënonte se qyteti është nën vëzhgim të kamerave dhe çdo vendosje e kamerave duhet me pas tabelën njoftuese për zonën e cila është nën vëzhgim të kamerave.

**Mefail Suma** thekson:- titulli i vendimit është për bartjen rialokimin e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake, është fjala për bartje se nga viti 2016 janë bartur mjetet financiare në vitin 2017 dhe nga viti 2017 barten në vitin 2018. A është fjala për ribartje apo vetëm për bartje sepse me sa e kuptojë alokimin dhe rialokimin a e ka kuptimin e njëjtë për bartje dhe ribartje apo ka tjetër kuptim.

**Florim Shkreta** thekson:- a është tu pas rezultat te zonat urbane për vendosjen e kamerave që mendoni me i vendos në zonat rurale apo vetëm doni vetëm ta rehatoni dikend që me bërë punë kot.

**Shabi rexhallari** thekson:- sa i përket mjeteve financiare janë të shpërndara në tabel në detale. Veturat zyrtare janë të planifikuara me buxhetin të cilin e kemi miratuar në vitin e kaluar por për shkak se na duhen shtesë e kemi vendosë shumën në vlerë 10 000 €. Alokimi dhe rialokimi kanë dallime. Rialokimi është kur mjetet financiare më herët kanë që të llokume dhe tash bëjmë rialokim prapë i vendosim diku tjetër. Ministria e financave e ka përcaktuar titullimin në këtë mënyrë.

**Rufki Suma** thekson:- vendosja e kamerave në qytet ka pas efekt shumë pozitiv sepse disa vjedhje të cilat kanë ndodhë janë zbuluar pikërisht për shkak të kamerave, disa ndeshje në komunikacion të cilat kanë ndodhë janë zbuluar përmes kamerave. Disa dëmtime të drunjve të cilët i kemi nëpër qytet janë identifikuar personat të cilët i kanë dëmtuar dhe u është shqiptuar gjobë. Është projekt i policisë për me i vendosë edhe në disa pika kyçe në bashkëpunim me komunën që me u vendosur edhe në zonat rurale.

**Florim Shkreta** thekson:- kush i kontrollon kamerat të cilat janë vendosur. Potencuat që janë zbuluar ndeshjet por unë mendoj që janë zbuluar ndeshjet të cilat kanë ndodhë në mes të ditës të cilat edhe pa kamera ishin zbuluar. Unë mendoj se nuk janë duke pasur efekt aq sa duhet, dhe sipas fjalëve të cilat potencohen nga qytetarët thuhet se kamerat i kontrollon kryetari i komunës. Unë mendoj se duhet të dihet personi i cili i kontrollon sepse nuk besoj që është e drejtë që kryetari i komunës t'i sheh personat në privatësinë e vetë , apo ndoshta dikujt edhe në oborr ja keni vendosur kamerën.

**Rufki Suma** thekson:- kamerat janë të vendosura në zonat publike dhe menaxhohen prej policisë e cila i kontrollon. Kemi edhe në komunë por zyrtarisht i kontrollon dhe i menaxhon policia nëse ka të bëjë çoftë për ndonjë ndeshje çoftë për vjedhje. Janë të vendosura në dy vende por menaxhohen dhe kontrollohen prej policisë.

**Florim Shkreta** thekson:- cilat kamera i kontrollon komuna dhe ai kontrollon edhe kamerat e qytetit.

**Rufki Suma** thekson:- po i kontrollon se ka edhe të qytetit edhe të komunës sepse kamerat janë të vendosura në zonat publike.

**Florim Shkreta** thekson:- nuk besoj që është e drejtë kjo.

**Rufki Suma** thekson:- është ekipi monitorues prej Prishtinës i cili i kontrollon nëse ka shkelje të privatësisë.

**Kryesuesi** thekson:- unë mendoj se po që se është gabim nuk i vendosin tërë qytete e Kosovës , mirëpo ne jemi komuna e parë por besoj se jeni në ngjarje që gjitha komunat e Kosovës janë duke i vendosur. Efekte besoj që ka se po të shikoni vendet e Evropës të gjitha vjedhjet zbulohet për mes kamerave. Sa i përket kontrollës është e ditur se policia i kontrollon.

**Florim Shkreta** thekson:- objektin e komunës është normale nëse e kontrollojnë por nuk i intereson se çka bëjë unë si qytetarë sepse unë hyjë diku tjetër e ty me më përcjellë prej objektit të komunës. Unë nuk jam kundër vendosjes së kamerave dhe është mirë që ata të cilët i vendosin kamerat t'i vendosin në mënyrë profesionale.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR BARTJEN (RIALOKIMIN) E BUXHETIT TË PA SHPENZUAR NGA VITI I KALUAR NË VITIN AKTUAL.**

#### 4. Shqyrtimi i raportit një vjeçar të NPL "PASTRIMI".

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Abil Thaçi** (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të NPL "Pastrimi") thekson:- kjo ndërmarrje është themeluar me dhjetë gushtë të vitit 2016 me vendim të kryeministrit të Kosovës dhe ka filluar punën me një janar të vitit 2017. Ndërmarrja bënë menaxhimin e mbeturinave dhe gjithsejtë ka nëntë punëtorë. Ndërmarrja ka bordin e drejtorëve që përbëhet prej pesë anëtarëve që përfshihet edhe kryeshefin ekzekutiv. Ndërmarrja ka filluar edhe shtrirjen në fshatin Gorancë, Dimcë dhe Krivenik. Gjatë viti 2017 janë nënshkruar gjithsejtë 840 kontrata familjare dhe 62 kontrata biznesore. Gjatë vitit 2017 kemi arritur të arkëtojmë gjithsejtë 55120.00 € të hyra në ekonomit familjare dhe bizneset. Kompania është subvencionuar edhe nga komuna në vlerë prej 9073.00 €. Të hyra kemi pas edhe në formë donacioni nga shoqata Nën Terezë në shumë prej 2700 €. Shpenzimet e ndërmarrjes janë më të mëdha se inkasimi në shumë prej 62.201.31 €. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabedin Hasallari** thekson:- a e përfshin gjithë territorin e Hanit të Elezit kompania "Pastrimi". Në bazë të raportit që është përcjellë ndërmarrja ka inkasuar 55120.00 € dhe nuk ka mundur me funksionuar pa donacionet të cilat i ka dhënë komuna dhe shoqata "Nën Terezë". A ka ndonjë plan kjo kompani që të funksionon me mjetet financiare të vetat. A është mor vendim në bordin e kësaj kompanie për disa ekonomi familjare të cilat i përcjell në përmbarues privat sepse është një barrë e madhe për këto familje por edhe shumica e banorëve nuk e dinë se çka është përmbaruesi privat. Qytetarët të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë me kompaninë për bartjen e mbeturinave ku i hedhin mbeturinat e tyre.

**Isni Bushi** thekson:- si është menduar të bëhet për personat të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë dhe për ekonomitë reja me bërë regjistrimin për me i pajisur me kontinjer. Është mirë të zgjidhet kjo çështje sepse qytetarët të cilët kanë bërë kontratë janë dërguar në përmbarues kurse tjerët nuk kanë bërë kontrata dhe mbeturinat i hedhin në vende të ndryshme.

**Akif Shkreta** thekson:- Hani i Elezit është zonë industriale e ndotur dhe në këtë vit do të vazhdon ndotja edhe më shumë si pasoj e punimeve të ndërtimit të autostradës dhe kompania në këtë vit duhet të jetë shumë më efikase.

**Nuriman Kuka** thekson:- sa është numri i punëtorëve në kompani dhe a ka ndonjë projekt në të ardhmen për daljen nga kjo situatë për shkak se punëtorët të cilin punojnë duhet të paguhet për shkak se materialin të cilin e kemi pranuar shihet se kompania është në minus.

**Mefail Suma** thekson:- ndërmarrja a është shoqëri me përgjegjësi të kufizuara apo pa përgjegjësi të kufizuara.

**Florim Shkreta** thekson:- rastet sociale a paguaj apo nuk paguajnë. Me që komuna participon a do të kishte qenë e mundur që të zvogëlohet tarifa për bartjen e mbeturinave nga 5 € në 3 € pasi që kompania ka mbështetje prej komunës.

**Abil Thaçi** (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të NPL "Pastrimi") thekson:- sa i përket shtrirjes kompania është në proces për shtrirjen e veprimtarisë në tërë territorin e komunës së Hanit të Elezit. Personat të cilët hedhin mbeturina në mënyrë jo të lejuara duhet që përmes inspektoratit të komunës që të dënohen . Ka raste që dy familje i hedhin mbeturinat me një kontinjer dhe për atë nuk kemi numër të saktë të ekonomive familjare. Sa i përket përmbaruesit kompania e ka të caktuar shumë dhe nëse kalohet ajo shumë e mos pagesës lënda dërgohet në përmbarues. Numri i punëtorëve në kompani është nëntë. Ndërmarrja është publike komunale me një qind për qind aksione të komunës dhe është shoqëria aksionare ka bordin menaxhues. Është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar vetëm menaxhimin e mbeturinave. Edhe rastet sociale paguajnë për bartjen e mbeturinave. Jemi kompani fillestare dhe çdo kompani ka probleme në fillim dhe në të ardhme ndoshta do të diskutohet edhe për çështjen e tarifave por edhe për një kohë nuk do të jetë e mundur zbritja e tarifave.

**Rufki Suma** thekson:- kjo kompani në aktin e themelimit shënon ndërmarrje publike lokale pastrimi shoqëri aksionare dhe nuk ka asnjë element tjetër me përgjegjësi të kufizuara apo të pakufizuara. Është kompani e parë për mbeturina në nivel të Kosovës . Sa i përket subvencionimit ka qenë obligim ligjorë që çdo kompani e cila themelohet në fillim me vendim të Qeverisë potencon që komuna ka obligim ligjorë që ta subvencionon me 10 000 € sepse llogaritet që është kompani e re. Nëse vërtetohet se kompania është në krizë kuvendi ka drejtë me subvencionuar për shkak se kuvendi është qind për qind aksionarë. Unë po besoj se nuk do të ketë probleme sepse numri është tu rritë i ekonomive familjare. Kompania nuk ka të drejtë ta ndryshon çmimin sepse komuna është aksionare dhe kuvendi e ka miratuar rregulloren për përcaktimin e çmimit. Me përmbaues janë dënuar qytetarët më të ndershëm dhe ata të pa ndershmit kanë shpëtuar sepse nuk kanë lidh kontratë me kompaninë. Qytetarët e ndershëm të cilët kanë lidhë kontratë dhe nuk kanë mundur me paguar janë dënuar. Kompania nuk ka qenë e njoftuar shumë për çështjen e përmbauesve. Si komunë i kemi rekomanduar kompanisë që fillimisht me njoftuar palën dhe nëse ata nuk përgjigjen me dërguar lëndën në përmbaues. E njëjta çështje do të jetë edhe me tatim në pronë por do t'i njoftojmë qytetarët. Si kompani që ka filluar për herë të parë lirisht mundemi me vlerësuar që është e suksesshme.

**Teuta Shkreta** thekson:- përshëndes raportin e kompanisë dhe është mirë që të kontrobojmë të gjithë që së paku ta japim një shtytje për këtë kompani. Te Ura e Seçishtës të pastrohen mbeturinat që janë afër lumit Lepenc për shkak se kundërmon erë e rëndë dhe në atë pjesë ka frekuentim të qytetarëve.

**Rufki Suma** thekson:- kompania dhe drejtoria e shërbimeve publike i ka identifikuar deponitë ilegale dhe ju e dini që muaji mars dhe prill janë aktivitete të aksioneve. Është e planifikuar që të fillohen këto aksione se ne e dimë që në fshatin Dimcë dhe në disa fshatar tjerë ka deponi ilegale për shkak se kamioni për bartjen e mbeturinave nuk ka mundur dal dhe ka filluar me i bart edhe atje prej vitit të kaluar. Kemi biseduar me kryetarët e këshillave të fshatrave që të pastrohen të gjitha deponitë nëpër fshatra.

**Florim Shkreta** thekson:- e di që në fshatin Dimcë munden që të hidhen mbeturina në mënyrë ilegale sepse nuk ka vëzhgim të kamerave, mirëpo te Ura e Seçishtës janë të vendosura kamerat dhe si lejohen këto gjëra. Kompani "Pastrimi" a mundet në të ardhmen me u privatizuar.

**Sabedin Hasallari** thekson:- nga kush është marr vendimi për me i dërguar në përmbaues personat të cilët nuk i kanë paguar mbeturinat. A parashihet me pas ndonjë pikë grumbulluese komuna jonë për mbeturinat e ngurta.

**Mefail Suma** thekson:- konfiguracioni i rejlefit në fshatin Dimcës është specifik në krahasim me fshatrat tjerë. Po marrim shembull lagjen Bushi në Puset e Nikës si bëhet bartja e mbeturinave sepse nuk besoj që kamioni mundet me shkuar atje. Edhe në fshatin Dimcë kushtet janë në atë mënyrë që kamioni ka vështirësi për bartjen e mbeturinave. Banorët e fshatit Dimcë nuk kanë dashur me bërë deponi ilegale por është dashur diku me i hedh ato mbeturina.

**Akif Shkreta** thekson:- vitin e kaluar kemi aplikuar për një film dokumentarë dhe e kemi identifikuar grumbullimin e mbeturinave në formë ilegale dhe kemi qenë te ura e Seçishtës duke e ixhizuar filmim dhe kemi identifikuar ambientin e pa pastër dhe kemi dal te fshati Laç ku është ambienti i pastër. Inxhizimin e kemi bërë para dite kurse pas dite janë pastruar që do të thotë që kanë pas efekt kamera. Sa i përket mbeturinave te Ura e Seçishtë dihet adresa dhe nëse ka përmbaues për me i dënuar personat e ndershëm ne të ketë edhe për ata të pandershmit që ju pengojnë të ndershëmëve.

**Rufki Suma** thekson:- deponin e ngurta është e vërtete që jemi të obliguar me gjet. Kompania nuk mundet me u privatizuar për shkak se është kompani publike.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I NJË VJEÇAR I NPL "PASTRIMI"

**5. Miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

**U MIRATUAR PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2018**

**6. Miratimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2017.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

**U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2017**

**7. Miratimi i raportit të punës së tri Komiteteve Konsultative për vitin 2017.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

**U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2017.**

**8. Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nuriman Kuka thekson:- propozoj që së paku në çdo dy muaj me u kyç edhe administratorët e fshatrave për arsye se mund të koordinohen punët më mirë.

Rufki Suma thekson:- kjo çështje është diskutuar edhe më herët, mirëpo me udhëzim administrativ përcaktohet se kush merr pjesë në këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës së rendit të punës.

**9 . Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- si kryetarë i këshillit të fshatit Seçishtë nuk kam përcjell raport dhe nëse është i interesuar dikush me informuar mund të ju përgjigjem.

Mefail Suma thekson:- në material janë përcjellë raporti që është punuar për vitin 2017. Së pari këshillat e fshatrave e kanë gabim se asnjëri përveç fshatit Gorancë që e kam parë që e ka përpiluar një raport të punës, mirëpo komuna duhet që tua kërkojë planin e punës se çka do të punojnë për vitin 2018 . Një herë kam dhënë vërejtje për fshatin Dimcë se që 8 (tetë) vite që funksionon asnjë herë nuk është mbajtur mbledhje dhe po shihet se të gjithë janë ashtu. Në raportin e administratorit të fshatit Gorancë shënon se kam biseduar në telefon me KEDS-in për ndërprerjen e rrymës, që mendoj se nuk është aktivitet. Administratori i Hanit të Elezit shënon raporti i aktiviteteve të vendbanimit të Hanit të Elezit, por vendbanimi nuk jep aktivitete. Në raport fjalitë i ka nisur në njëjës dhe i ka përfunduar në shumës dhe unë mendoj se fjalia kur të niset në njëjës duhet të përfundon me numrin njëjës. Pastaj ka potencuar në raport se disa herë në thirrjet e mia mos e shpenzoni ujin por ai duhet me dhënë ide se si me pas ujë dhe mos me lidh hoxhallikun me administratorin për shkak se ai ka bërë thirrje në Xhami. Në raport ka shënuar aktivitete për ditën e bajramit, aktivitete për ramazan por pse nuk e ka

përmendur aktivitetin për vitin e ri se ndoshta me siguri dikush ka sjell bombunjera por me siguri nuk i përmendë për shkak se është hoxh. Komiteti për politik e financa duhet me najë përgatitur pak më mirë materialin sepse nëse dihet se ka kaluar në KPF nuk vonohemi edhe në mbledhje të kuvendit.

**Nuriman Kuka** thekson:- a paguhen administratorët e fshatrave. Administratori i fshatit Seçishtë ka kryesinë dhe i ka menaxhuar punët e veta mirë por pse nuk ka paraqitur raport është çështje e tij personale. Raportet e këshillave të fshatrave të cilat janë përcjellë nuk më kanë pëlqyer për shkak se me një raport thuhet se kam dal me lojtarët e Sharrit te Varrezat e Dëshmorëve. Te varrezat e Dëshmorëve e kemi obligim si qytetarë me dal dhe nuk është dashur të jetë në raport. Mendoj se administratori i Hanit të Elezit nuk ka këshill sepse fillimisht duhet të bëhet plani i punës dhe në fund të vitit të bëhet raporti i punës, këtë e them për të gjithë administratorët e fshatrave.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:-pse nuk ka paraqitur fshati Seçishtë asnjë raport.

**Rufki Suma** thekson:- kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane nuk paguhen por zgjidhen për mes një rregullore e cila është miratuar në kuvendin e komunës.

**Florim Shkreta** thekson:- arsyeja se pse nuk kam dhënë raport është se bashkëpunimi nuk ka qenë i sinqertë në mes juve. Shohë që disa takime që kam majtë administratorët por unë as që kam qenë në dioni për ato takime. Në aktivitete të cilat i kam ndërmarr kam pas pengesa nga komuna e jo mbështetje. Takime nuk kemi pas ashtu siç është biseduar se do të kemi. Komunën nuk e akuzoj që nuk na ka paguar sepse askush me zor nuk na ka shtijë por kemi hyrë me vullnet . Ka pas administratorë të fshatrave të cilët çdo here në mendje e kanë pas se athu kur do të na paguajnë, mirëpo komuna nuk është dashur me potencuar por është dashur që në fillim me treguar që nuk ka pagesë për këtë çështje. Neglizhente ka qenë edhe te administratorët e tjerë edhe për atë nuk e kam pa të arsyeshme me dhënë raport sepse nuk kanë qenë korrekt të paktën me mu , kurse me tjerët nuk e di.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës së rendit të punës.

#### **10 Miratimi i kërkesës së kompanisë “ACHRO” SH.P.K.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- për kompaninë në fjalë kuvendi ka dhënë pëlqim në mbledhjen e kaluar ka parashtruar kërkesë edhe për një parcelë shtesë e cila kufizohet me parcelën ekzistuese për shkak se në vend ngjarje kur është dal projektuesi ka konstatuar se më i përshtatshëm është tereni edhe në një pjesë shtesë të parcelës. Kuvendi jep vetëm pëlqim në parim kurse lejen e jep agjensioni pyjorë për shkak se prona është e tyre.

**Florim Shkreta** thekson:- po bisedohet nëpër qytetarë për çështje të punësimeve dhe nuk është mirë me ja marr dikujt kafshatën e bukës e me ja dhënë tjetrit vetëm pse nuk është i një pushteti apo i një partie politike që i konvenon. Unë mendoj se nuk është e ndershme kjo për shkak se po ka fjalë prej personave të ndryshëm që po ankohen dhe po potencojnë se nuk jam me kryetarin dhe nuk mundem me hynë në punë dhe nëse je me PDK-në nuk mundesh me u punësuar asnjë herë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA KËRKESA E KOMPANISË “ACHRO” SH.P.K.**

## 11 . Miratimi i kërkesës për ndërrim destinim të pronës.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela thekson:-** kërkesa është bërë me kohë por problem ka qenë çështja e pronës për shkak se ka qenë në emër të pronarëve privat dhe pas zhvillimit të procedurave prona është dal në emër të Bashkësisë Islame dhe kemi bërë procedimin për miratim në kuvend. Ndërrim destinomi me udhëzim administrativ duhet të paguhet por këtu është problemi se është objekt fetarë dhe duhet të shikojmë mundësitë për me liruar prej pagesës.

**Bajrush Laçi thekson:-** kuvendi është mirë që të merr vendim për me i liruar nga të gjitha taksat për shkak se është objekt fetarë dhe është për të mirën tonë.

**Kryesuesi thekson:-** ku është përcaktuar ky lokacion për ndërtimin e Xhamisë. Unë nuk jam kundër Xhamive sepse të gjithë i përkasim kësaj feje por problemi është se janë duke u ndërtuar shumë dhe a e shikojnë anën financiare apo mendojnë që me rritë anëtarësinë 10 € për person. Te pagesa e anëtarësisë ka dallime sepse komunat e tjera paguajnë 2 € për person, kurse në Han të Elezit 5 €. Kjo pyetje duhet t'i bëhet Bashkërisë Islame por ne vetëm po e diskutojmë.

**Zaim Bela thekson:-** Xhamia do të ndërtohet në fshatin Paldenicë dhe në raportin e komisionin shënon edhe me numër të parcelës dhe lokacioni se ku do të ndërtohet.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

### MIRATOHET KËRKESA PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

#### 1. Pyetje dhe përgjigje.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma thekson:-** kërkoj përgjigje me shkrim për pyetjet të cilat do t'i parashtrijë. Pse nuk vjen gazeta në Han të Elezit ? Pse sistemi i informimit në komunë është i dobët? Pse zyra e informimit shkruan vetëm për punën e kryetarit? Pse sistemi i informimit nuk shkruan për anëtarët dhe punën e kuvendit të komunës? Pse nuk ftohen në mbledhje të kuvendit gazetarët ? Pse nuk publikohen mbledhjet e kuvendit drejt për së drejti në "Elektra". Kërkoj që së paku zyra e komunës të informojë nëpërmes rrjetit "Elektra" me shkronja për punën dhe diskutimet në kuvendit të komunës.

**Nuriman Kuka thekson:-** duhet të jemi vigjilentë ndaj pastrimit në Han të Elezit sepse po kemi vërejtje nga qytetarët për shkak se pastërtia është zero. A ekziston ndonjë plan në komunë për renovimin e ndërtesave në Han të Elezit.

**Akif Shkreta thekson:-** për arsim janë të planifikuara 25000 € te shkolla fillore "Ilaz Thaçi", propozoj që te hyrja e shkollës me u mbyll ajo pjesa dhe me u mbuluar shkallët për shkak se hynë shiu edhe bora dhe ora e fundit që ra janë lënduar shumë nxënës.

**Isni Bushi thekson:-** a ekziston mundësia që me u vendosë disa drita para sallës së sporteve për shkak se disa klube aktivitete e tyre po i kryejnë në mbrëmje.

Rufki Suma thekson:- nëse drejtoria e arsimit e vlerëson që duhet ë bëhet ai projekt nuk ka ndonjë problem. Sa i përket pastrimit kemi diskutuar me kompaninë “Bektelenka” për këtë çështje por si komunë deri sa të kryhen punimet kemi me pas problem. Për renovimin e objekteve të vjetra shpesh kemi pas kontakte me donatorë por ju e dini që shumica janë banesa private dhe pa pëlqimin e banorëve nuk mundemi me i rregulluar. Kemi biseduar me banorët që përmes KFOR-it Turke me i rregulluar por banorët nuk ka pranuar dhe kanë potencuar që nuk duam me bërë ndryshime.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit në pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 12:54.

Procesmbajtësi  
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit  
MSc. Qamush Brava

